



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E TURIZMIT.  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

**Raportimi Financiar për vitin 2023**  
**12 mujori Janar-Dhjetor 2023**

**A .PËRMBLEDHJE**

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.458 date 18.01.2024, protokolluar me tonen me nr.748 date 19.01.2024 mbi “Mbi përgatitjen e Raport të Monitorimit për zbatimin e buxhetit të vitit 2023, nëpërmjet këtij raporti paraqitet në mënyrë të përmbledhur aktiviteti financiar për periudhën Janar – Dhjetor 2023.

Raporti synon të jap realizimin e objektivave kryesore të punësimit dhe realizimin e shpenzimeve sipas planifikimit buxhetor të vitit 2023, për 12-mujorin e vitit 2023

**B.MENAXHIMI FINANCIAR**

Menaxhimi financiar bëhet bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

- Fonde te çelura nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, sipas shkresës nr. 487/1 prot, datë 30.01.2023 janë si më poshtë:

- Paga	22,100,000 lekë
- Sigurime shoq. dhe shend.	3,600,000 lekë
- Shpenzime operative	42,420,000 lekë
- Fondi i veçantë	100,000 lekë
- Gjithashtu me shkresën nr. 3033/5 prot, datë 07.06.2023 është njoftuar rialokim fondi ne zërin “Shpenzime operative”, Aktivitete per eventet dhe promovimin e turizmit, shtesë në shumën 30,000,000 lekë.
- Me shkresën nr.4512/1 prot date 24.07.2023, protokolluar me tonën me nr.424 datë 27.07.2023 është akorduar fond për rritjen e pagave për vitin 2023 shtesë në llogarinë 600 ne shumën 5,000,000 lekë dhe ne llogarinë 601 në shumën 840,000 lekë.

Akordimi fondit per rritjen e pagave është derguar prane Deges Thesarit , rritja e shpenzimeve ne zerin Paga dhe Sigurime si rezultat i efekteve te rritjes se pagave ne zbatim te VKM-se nr.35 datë 31.05.2023 “Për miratimin e struktures së pagave niveleve të pagave ,dhe shtesave të tjera mbi page të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve civilë dhe Nëpunësve në disa institucione të administratës publike”

- Me shkresën nr.4355/4 prot datë 15.08.2023, protokolluar me tonën me nr.480 date 16.08.2023 është bërë transferim fondi për shpenzime kapitale, llog 231, në zërin “Orendi dhe pajisje” për blerje kondicionere ne shumen 600,000 lekë.
- Me shkresën nr.7095/1 prot datë 11.12.2023, derguar nga MTM “Miratim fondi”janë bërë rialokimet si më poshtë::

- 600 – Shpenzime Paga	- 3,000,000 leke
- 601 – Shpenzime sigurime	+ 500,000 leke

Buxheti i rishikuar me ndryshimet e ndodhura gjate vitit në fund të periudhës rezulton si më poshtë dhe janë pasqyruar në Rakordimet me thesarin për çdo muaj dhe progresive:

- Paga	20,000,000 lekë
- Sigurime shoq. dhe shend.	4,540,000 lekë
- Shpenzime operative	72,420,000 lekë
- Fondi i veçantë	100,000 lekë

Përmbledhese e fondeve te alokuara në tabelën më poshtë:

lekë

Nr	Emertimi	Shuma
1.	Fondi i pagave	20,000,000
2.	Fondi për sig shoqërore dhe shëndetësore	4,540,000
3.	Fondi për shpenzime operative	72,420,000
4.	Fondi special 606	100,000
5.	Investime	600,000
	<b>Totali</b>	<b>97,660,000</b>

Realizimi i fondeve për vitin Janar – Dhjetor 2023.

Tabela e realizimit

Nr	Emertimi	Plani vjetor J-Dhj 2023	Fakti 12-mujor J-Dhj 2023	% e real.
1.	Shpenzime për paga	20,000,000	18,411,135	92%
2.	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,540,000	2,858,294	
3.	Shpenzime operative	72,420,000	71,947,134	99.3%
4.	Fond special	100,000	0	
5.	Investime	600,000	571,848	95%
	<b>Totali</b>	<b>97,660,000</b>	<b>93,788,411</b>	<b>97%</b>

## 1. Performanca analitike e buxhetit

### - Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore edhe shëndetësore

Buxheti i alokuar për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore në fund të 12 muorit 2023 me ndryshimet e ndodhura gjatë vitit është 20,000,000 lekë, i cili është realizuar gati në masën 90% dhe nr I punonjësve në fund të periudhës nga 24 ishte 21.

Me hyrjen në fuqi të VKM-se nr.35 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave niveleve të pagave ,dhe shtesave të tjera mbi page të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve civilë dhe Nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, fondi i pagave llogaritet në zbatim të kësaj VKM-je.

Marrëdhëniet e punës të Drejtorit të Përgjithshëm dhe punonjësve të Agjencisë tashme rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr.7961 date 12.7.1995 ”Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar.

Aktualisht nga 24 punonjës që ka struktura janë të punësuar 21 punonjës nga të cilët 1 praktikante e përzgjedhur sipas Thirrjes shtate të PKPP-së dhe 1 punonjës mbështetes (sanitar).

### Shpenzimet operative

Për shpenzimet operative fondi i alokuar është 72,420,000 lekë. Sipas regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike 2023, jepet realizimi zë më zë i shpenzimeve (llog 602) në tabelën më poshtë:

Nr	Emertimi I shpenzimeve	Buxheti	Realizimi	%
1	Kancelari + Bojra printeri	1,400,000	1,054,750	75 %
2	Materiale Pastrimi	120,000	119,650	99%
3	Energji elektrike	400,000	183,734	46%
4	Shërbime uje	60,000	40,344	67%
5	Shërbime postare	30,000	14,430	48%
6	Sherbime qera transporti	1,109,304	1,109,304	100%
7	Mirembajtje faqet web	1,200,000	1,162,800	97%
8	Sherbim realizim Fushate promovimi ne rrjetet sociale	792,000	720,000	91%
9	Sherbim printim adegziv	120,000	120,000	100%

10	Karburant dhe lubrifikant	720,000	708,000	98%
12	Taksa dhe siguracione automjeti	50,000	18,196	
13	Taksa vendore/parkimi etj.	230,000	239,727	92%
14	Shërbime për mirëmbajtje të mjeteve te transportit (vaj, filtra)	120,000	60,407	50%
15	Mirëmbajtje objekti, lysterje dhe patinim	1,200,000	1,067,760	89%
16	Mirëmbajtje riparim dyer dritare dhe grila	1,200,000	1,017,600	85%
17	Mirembajtje e riparim kompjuterash	120,000	100,800	84%
18	Udhëtim e dieta brenda vendit	1,500,000	1,347,832	90%
19	Udhëtim e dieta jashtë vendit	1,500,000	1,340,485	89%
20	Bileta avioni	1,500,000	1,142,010	76%
21	Aktivitete brenda dhe jashte vendit (fam trip, panaire, press trip)	24,000,000	23,440,764	98%
22	Sherbim administrative turistik foto video konkursi wanderlast	11,000,000	9,480,000	86%
23	Materiale Promocionale	4,600,000	3,771,000	82%
24	Shpenzime Gjyqesore	80,000	-	
25	Sherbim perkthime e noterizime	120,000	117,565	98%
26	Realizim prodhim spotesh dhe mbulim mediatik.	25,000,000	24,647,520	98%
27	Honorare (keshilltar I jashtem)	50,000	49,455	99%
28	Sherbime bankare	100,000	35,802	36%
29	Te tjera	500,000	437,282	87%
	<b>Totali</b>	<b>72,420,000</b>	<b>71,947,134</b>	<b>99.3%</b>

## - **Investimet**

Agjencia Kombëtare e Turizmit ka fonde të çelura nga buxheti i shtetit për investime për vitin 2023, në zërin “Orendi dhe pajisje” për blerjen e kondicionereve sipas kërkesës së bërë nga AKT dhe miratuar nga MTM në vlerën 600,000 leke, pasi sistemi ngrohje -ftohje nuk ekziston dhe si rezultat nuk ka pajisje të cilat janë të nevojshme për këto qëllime.

Gjithashtu nevojiten rregullime të ambienteve dhe zyrave si nga pikpamja e nderhyrjes me investime dhe blerje mobilje zyre dhe pajisje informatike në funksion të aktivitetit tëone për pasqyrimin digital të promovimit të turizmit.

## - **Realizimi i objektivave**

Objektivi kryesor është zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit dhe Strategjinë Kombëtare të Marketingut për sektorin e Turizmit , zbatimi i politikave të marketingut në fushën e turizmit për promovimin e turizmit shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, krijimin e infrastrukturave të nevojshme për dhenie informacioni për vizitore udhëtare dhe turist në lidhje me kapacitetet turistike ,destinacionet turistike ,shërbimet turistike (Kalendari kulturor) që ofron vendi ynë.

Zhvillimin e një aplikacioni për eventet turistike me qëllim promovimin e Shqipërisë turistike përmes eventeve kulturore sportive dhe të trashëgimisë të ofruara në të gjithë territorin e vendit. Ky kalendar do të shërbejë në lehtësimin e dhenies së informacionit të aktivitetëve dhe do të nxisë interesimin e vizitoreve vendas dhe të huaj për të njohur shqipërinë në të gjitha dimensionet e saj.

Zhvillimin e projekteve për turizmin sipas fushës së veprimtarisë,promovimi si brenda dhe jashtë vendit të produkteve dhe destinacioneve turistike duke bashkëpunuar me organizma të tjera që operojnë në fushën e turizmit.

Ketu përmendim pjesëmarrjen në Panairin e Berlinit , ITB Berlin në datat 5-7 mars 2023 . Në këtë panair marrin pjesë rreth 180 shtete dhe afro 6000 të mediave të ndryshme prestigjioze.Cdo vit ITB mirëpret rreth 10,000 ekspozues nga më shumë se 180 vende e rajone.

AKT-ja së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit mori pjesë në të më të stenden e Shqipërisë e konceptuar me një dizajn dhe arredim modern ku në qendër të saj është vendosur shkrimi “Albania. All you need is here”, me tre ekrane Led, në një sipërfaqe të marrë me qera prej 88 m2.

Rëndësia e këtij panairi është strategjike dhe e padiskutueshme duke konsistuar në një rritje të tregut gjerman dhe më tej. Aktualisht Gjermania shënon rritjen më të madhe ndër tregjet e huaja që frekuentojnë Shqipërinë ,

Agjencia Kombëtare e Turizmit mori pjesë në Panairin e 29 Ndërkombëtar të Tiranës, më i madhi panair i biznesit në Shqipëri, ku prezantoi potencialet e Shqipërisë në turizmin e qëndrueshëm gjithëvjetor, përmes stendës së saj dhe paneleve të ndryshme, në datat 6 deri më 9 Dhjetor 2023.

Për herë të parë u krijua kalendari kombëtar i eventeve turistike, kulturore, sportive dhe të traditës, databaza e parë e të dhënave rreth aktiviteteve dhe aplikacioni i tij TEA. Shqipëria turistike po brandohet përmes trashëgimisë kulturore dhe eventve multiart. Tashmë na jepet mundësia të prodhohen për herë të parë paketat e turizmit kulturor duke i shtuar aktraksioneve natyrore dhe destinacionet artistike lehtësisht të arritshme përmes aplikacionit TEA.

Per promovimin e tij u realizuan procedurat per prodhim transmetim video(spote) nga AKT-ja ku per periudhen 8 mujore u permbyllen 5 spote me tematike mbi perdorimin e aplikacionit TEA dhe Zbulo Shqiperine nepermjet aplikacionit TEA dhe promovimi I tyre ne rrjete sociale , media dhe emisione televizive.

Ky aplikacion pergjate këtij viti u bë udhërrëfyysi i mijëra turistëve që kanë vizituar vendin përgjatë sezonit turistik 2023 pasi pranë çdo event, vizitorët mund të gjejnë dhe atraksionet më të rëndësishme turistike. Kalendari i parë digjital i eventeve, ka arritur 22.000 shkarkime për rreth dy muaj, një shifër optimiste kjo për një hark kohor kaq të shkurtër. Ky aplikacion ka tërhequr vëmendjen e vizitorëve vendas e të huaj jo vetëm nga Shqipëria por nga e gjithë bota duke sjellë një standart të ri në industrinë e turizmit shqiptar, përmes kësaj risie teknologjike.